



Република Северна Македонија
Republika e Maqedonisë së Veriut

СУДСКИ СОВЕТ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА KËSHILLI GJYQËSOR I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Ул. "Македонија" бр.5, 1000 Скопје | тел.02/3218 130 факс.02/3218 131 | contact@ssrm.mk
Rr. "Makedonija" nr.5, 1000 Shkup | tel.02/3218 130 faksi.02/3218 131 | contact@ssrm.mk

Në bazë të nenit 105 paragrafi (1) alinea (1) nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, neni 41 dhe neni 47 të Ligjit për Gjykatat ("Gazeta Zyrtare e Republika e Maqedonisë" nr.58/2006, 35/2008, 150/2010, 83/18, 198/18 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr.96/19) dhe neni 50 dhe neni 51 të Ligjit të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.102/2019), Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut në seancën e mbajtur më 06.11.2024 miratoi:

VENDIM

PËR ZGJEDHJEN E GJYQTARIT NË GJYKATËN APELIT NË GOSTIVAR

Për gjyqtar në Gjykatën Apelit në Gostivar është zgjedhur:

1.Abdulla Azari- gjyqtar në Gjykatën Themelore Tetovë;

Ky vendim do të hy në fuqi pas mbarimit të potëfuqishëm të procedurës dhe do të publikohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

ARSYETIM

Këshillit Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut publikoi shpallje për zgjedhjen e 2 (dy) gjyqtarve në Gjykatën Apelit në Gostivar ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr.270/23 nga 19.12.2023).

Në shpalljen e publikur për në Gjykatën Apelit në Gostivar, në sferën civile janë paraqitur gjithësej 6 (gjashtë) kandidatë, nga të cilat njëri prej kandidatëve e ka tërhequr fletëparaqitjen.

Procedurën për zgjedhjen e gjyqtarit në Gjykatë Apelit në Gostivar, Këshilli e zbatoi në pajtim me Ligjin për gjykata, Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Rregulloren e punës së Këshillit Gjyqësor të Republika e Maqedonisë së Veriut. Në përputhje me Rregulloren për mënyrën e randimit të të kandidatëve për zgjedhjen e gjyqtarve në gjykatë më të lartë, Këshilli formoi Komision të cilën e verifikoi dorëzimin në afatin e fletëparaqitjeve dhe kompletimin e dokumenteve të kandidatëve të paraqitur në publikimin e shpalljes. Kandidatët e kanë të dhënë testin psikologjik dhe testin e integritetit, me të njejtët është bërë intervjuja, në përputhje me Ligjin për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Gjykatat (Gazeta Zyrtare e RMV nr.150/10) për kandidatët të cilët janë zgjedhur për gjyqtar në periudhën nga 26.11.2010 nuk mbahet punë praktike e njohurive me kompjuter, prandaj një kontroll i tillë krahasohet në pajtim me ligjin.

Komisioni i formuar nga ana e Këshillit Gjyqësor i RMV-së e pas realizimit të procedurës, Regullores për mënyrën e rangimit të kandidatëve për zgjedhjen e gjyqtarit në gjykatë më të lartë, ka bërë renditjen në bazë të kriterëve të parashikuara në nenin 48 paragrafi (20) i Ligjit për Këshillin Gjyqësor të RMV-së prej të cilës janë dhënë pikë të cilët janë paraparë aspektet e kriteriumeve dhe është formuar rang lista e kandidatëve, në të cilën kandidatët me pikë më të lartë rangohen në vendin e parë. Pas ankesave të tre kandidatëve për rangimin në komision, Këshilli vendosi në seancë, pas së cilës komisioni dorëzoi raport me renditjen përfundimtare të kandidatëve për zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Apelit në Gostivar.

RANGË LISTA PËRFUNDIMTARE- LISTA E KANDIDATËVE
Për zgjedhjen e 2 (dy) gjyqtarve në Gjykatën e Apelit në Gostivar- sfera civile

Nr.	Emri dhe Mbiemri kandidatit	Gjyqtar në	pika
1	Jetmir Hamzai	Gjykata Themelore Gostivar	72,6
2	Abdulla Azari	Gjykata Themelore Tetovë	70,5
3	Ilir Iseni	Gjykata Themelore Dibër	70,49
4	Aleksandra Pallashevska	Gjykata Themelore Civile-Shkup	64,2
5	Jehona Sadiku	Gjykata Themelore Civile-Shkup	58,9

Në përputhje të nenit 49 paragrafi (2) nga ligji i Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, është paraparë se për gjyqtar është zgjedhur kandidati i cili ka marë më së paku tetë vota nga numri i përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit me të drejtë vote.

Në nenin 50 paragrafi (1) nga i njëjti Ligj përcakton se Këshilli zgjedh gjyqtarin dhe kryetarin e gjykatës themelore dhe të apelit që gjendet në zonën e njësisë së vetëqeverisjes lokale ku 20% e qytetarëve flasin një gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonase, vendos në pajtim me nenin 49 të këtij ligji, ku duhet të ketë shumicën e votave nga pjesëtarët e pranishëm që u takojnë komuniteteve në të cilat nuk ka shumicë në RMV-së. Në përputhje të nenit 23 paragrafi (3) e Regullores të punës të Këshillit Gjyqësor të RMV-së është paraparë se nëse kandidati i parë i ranguar i listës gjatë votimit nuk i mer numrin e votave të duhur, votimi bëhet në mënyrë sekuenciale për kandidatin e radhës nga lista e renditjes

Në seancën e mbajtur më 06.11.2024, Këshilli Gjyqësor diskutoi në lidhje me kandidaturën për gjyqtar dhe anëtarët e Këshillit u deklaruan për arsyet për të cilën e japin votën e tyre, dhe të cilat janë shënuar në procesverbal të seancës së lartpërmendur, pas së cilës Këshilli ka votuar sipas renditjes të rangë listës.

Kandidati i parë rangë listës Jetmir Hamzai me 13 vota "Për" mori votat e duhur nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit me të drejtë vote, në përputhje me nenin 49 paragrafin (2) të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të RMV-së.

Me 5 vota "Për" kandidati mori shumën e votave të anëtarve të pranishëm që u takojnë komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, sipas nenit 50 paragrafi (1) të Ligjit për Këshillit Gjyqësor të RMV-së.

Kandidati i dytë i rangë listës Abdulla Azari me 13 vota "Për" mori votat e duhur nga numri i përgjithëshën i anëtarëve të Këshillit me të drejtë vote, në përputhje me nenin 49 paragrafin (2) të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të RMV-së.

Me 5 vota "Për" kandidati mori shumën e votave të anëtarve të pranishëm që u takojnë komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, sipas nenit 50 paragrafi (1) të Ligjit për Këshillit Gjyqësor të RMV-së.

Çdo anëtar i Këshillit me të drejtë vote ka dhënë arsytim për vendimin e tij për zgjedhjen e gjyqtarit, i cili parashikohet në nenin 5 paragrafi (3) të Ligjit për Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Kandidati Abdulla Azari ka stazh të përgjithëshëm 10 vjet e 4 muaj e 10 ditë nga dita e paraqitjes së shpallje. Si gjyqtar ka punuar me materje civile, gjatë vlersimit në periudhën 2019-2022 është vlersuar me notë pozitive, në përputhje me aktet nënligjore janë vlersuar kualiteti dhe kvantitetin e kreteriumeve dhe i njejeti është i ranguar në listë si i dyti në karahasim me kandidatët tjerë në listë.

Sipas arsytimit të dhënë nga anëtarët e Këshillit, rezulton se bëhet fjalë për një gjyqtar profesionist, gjyqtar jashtëzakonisht i përkushtuar, me përvojë, shembull i ndërgjegjës gjyqësor, pavarësisë, paanshmërisë, ndershmërisë dhe përgjegjësisë, gjyqtar me integritet, në mënyrë që të gjitha cilësitë dhe njohuritë e përmendura t'i transferoja në përvojën time të fituar dhe të bashkohesha me shpejtësinë dhe punën në një gjykatë më të lartë, në një çështje në Gjykatën e Apelit të Gostivarit.

Duke pasur parasysh të gjitha si më sipër, Këshilli Gjyqësor në Gjykatën Apelit Gostivar, në sferën civile, zgjodhi për gjyqtar Abdulla Azarin.

**KËSHILLI GJYQËSOR I
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**

**Kryetar,
Vesna Dameva**



Nr.09-2133/1

07.11.2024

Shkup